



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary

Nr. 139 / 2025
Datë: 03 / 11 / 2025

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, nr. 7/01 mars 2019), bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-68, pjesa IV, neni 81, si dhe neni 70, Rregullorja për Prokurim Publik me nr. 001/2022, mbi aktivitetin e menaxhimit të Kontratës, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Edona Berisha, Zyrtare e Lartë për Mbështetjen e Viktimave të Krimit, në Departamentin për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit, caktohet zyrtare përgjegjëse për menaxhimin e kontratës, dhe për mbikëqyrjen e realizuar të obligimeve dhe detyrave kontraktuese të specifikuar si në kontratën me titull **"Furnizim dhe shërbime të ndryshme kontraktuese për mbajtjen e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore,"** me numër identifikues të Prokurimit: 21500-25-8124-1-2-1, dhe numër të brendshëm 21500-25-018-121.
2. Zyrtarja përgjegjëse për menaxhimin e kontratës nga pika 1 e këtij vendimi ka për detyrë që:
 - 2.1. Të sigurojë që operatori ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat e referencës dhe kushtet e kontratës;

- 2.2. Të siguroj që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 2.3. Të siguroj që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 2.4. Të siguroj se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
- 2.5. Të siguroj që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 2.6. Të siguroj që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
- 2.7. Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 2.8. Të siguroj detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
- 2.9. Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimi;
- 2.10. Të jep detaje të plota për ndonjë ndërprerjeje të propozuar të kontratës Divizionit të Prokurimit dhe
- 2.11. Të dorëzoj raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga ZKA dhe Divizionin i Prokurimit.

3. Obligohet menaxherja e kontratës për zbatimin e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Arita KALANDERI
Sekretare e Përgjithshme

Vendimi iu dërgohet:

- Znj. Edona Berisha;
- Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Qasje në Drejtësi, Drejtësi Tranzicionale dhe Mbështetje të Viktimave të Krimit;
- Divizionit të Prokurimit;
- Arkivit të MD – së.